

VENDIM
Nr. 523, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 302, DATË 10.5.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET E USHTRIMIT, TË
MIRATIMIT E MONITORIMIT TË VEPRIMTARIVE KËRKIMORE-SHKENCORE
NË ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 302, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Subjektet/individët, të cilët kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë kërkimore-shkencore, dërgojnë elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*” kërkesën për miratim pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).”.

2. Në pikën 5, fjalët “...me shkrim...” hiqen.

3. Në pikën 6, togfjalëshi “...10 ditëve pune...” zëvendësohet me “...7 (shtatë) ditëve pune...”.

4. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Në rast se nga ana e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura konstatohet se kërkesa e paraqitur nga subjekti kërkues/aplikuesi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, e njofton atë përmes portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, duke i kërkuar subjektit kërkues/aplikuesit për të bërë plotësimet e nevojshme brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit unik qeveritar “*e-Albania*” për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera, dokumente me vullë elektronike. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura vendos për miratimin ose jo të kërkesës brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i këtij afati.”.

5. Në fund të pikës 10 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Njoftimi për miratimin apo refuzimin e së drejtës së ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”.”.

6. Fjalia e dytë, e pikës 15, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Konkretisht, aplikuesit dërgojnë elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*” raportin përkatës me rezultatet e arritura gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie.”.

7. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*” zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i kërkesës dhe i dokumentacionit për miratimin e ushtrimit të veprimtarive kërkimore-shkencore, si dhe i raportit mbi rezultatet e arritura gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama